

Date: 26.02.2021

NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit", Ligjin Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar dhe VKM 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", Kreu VI "Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B", pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B": Aplikim për leje tipi B
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së: K82 50 94 07 B
3. Adresën e vendodhjes së instalimit: Fier, Strum, vendlindsh, Njesia Administrative Strum, Bashkia Rostovo, Rrethi Fier, Qarku Fier
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim: F.D 39. Përpunim prerjeje dhe ilustrimi i merrmenit dhe furnex dekorative
5. Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkomunitar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
7. Konsultimet ndërkomunitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi: MUK EQ
8. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen: AKM
9. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit; info@akm.go.al

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë

Fotona Levani



Nr.kontakti

+355 696076200

PERMBLEDHJE JO TEKNIKE VLERESIM NDIKIMI NE MJEDIS

QARKU: FIER RRETHI: FIER, BASHKIA: ROSKOVEC, NJESIA ADMINISTRATIVE: STRUM, FSHATI:
VELMISH, RRUGA: PER NE FIER-BERAT, TE TJERA: NDËRTESE NJË KATËSHE, ZONA
KADASTRALE 2349, PASURIA NR.257/5

Aktiviteti: Përpunimi, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve
dekorativ. (Kapaciteti përpunues është 150-200 m³/ditë.)

KODI: ID 3.9

Roskovec 2021

Permbajtje

1. Instalimi dhe aktiviteti i tij;	2
2. Lenda e pare dhe ato ndihmese, sustancat e tjera dhe energjie perdororur ose e gjenerar nga instalimi;4	
3. Burimet e shkarkimeve nga instalimet;.....	4
4. Kushtet ne vendndodhjen e instalimeve dhe rastet e njohura historike te ndotjes;	4
5. Nayra dhe sasite e shkarkimeve te pritshme nga instalimi ne cdo vend/mjedis si dhe identifikimi i efekteve me te rendesishme te shkarkimeve ne mjedis;	4
6. Teknologjia dhe teknika te tjera te propozuara per parandalimin e shkarkimeve ose kur kjo nuk eshte e mundur, per pakesimin e shkarkimeve nga instalimi, vecanerisht duke zbatuar TMD;.....	7
7. Alternativat ne zgjedhjen e vendit te instalimit dhe teknologjise se perdorur;	8
8. Masat per parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve;	8
9. Masa per perdorim me eficence te energjise;	12
10. Masa te tjera te planifikuara ne perputhje me parimin e pergjithshme qe rregullojne detyrimin themelor te operatorit;	12

Permbledhje Jo teknike e VNM-se:

1. Instalimi dhe aktiviteti i tij;

Aktiviteti ketij subjekti do te jete zhvillimin e aktivitetit "Përpunimi, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ. e (Te gjitha instalimet tipi B)" e cila zhvillon aktivitetin subjekti "VELLEZERIT HOXHA 2007"shpk me numrin unik te identifikimit NUIS K82509407B ne zonen e njohur me emrin Fshati Velmish, Njesia Administrative Strume, Bashkia Roskovec, Rrethi Fier, Qarku Fier. Subjekti ka në pronësi një sipërfaqe prej 10866 m². Shoqeria Vellezerit Hoxha 2007 kerkon me ane te kesaj permbledhjeje jo teknike tju propozoj vazhdimin e ushtrimit te aktivitetit te perpunimit, prerje dhe ilustrimi i mermerit per tu pajisur me leje mjedisore tipit B.

Qellimi i ketij projekti eshte ndertimi dhe mirefunksionimi I procesit te perpunimit, prerjes dhe lustrimit te mermerit dhe gureve dekorativ. Subjekti per zhvillimin e aktivitetit te tij do te disponoje brenda siperfaqes se lejuar qe ka ne pronesi te gjithe linjen teknologjike qe nevojitet per te zhvilluar aktivitetin e sipercituar

Kapaciteti:

Kapaciteti vjetor i prodhimit instalues per produktet eshte si meposhte:

Kapaciteti përpunues është 150-200 m³/ditë

Te dhenat urbanistike te prones ku ushtrohet aktivitet:

Siperfaqe e stabilimentit ne total eshte: 10,866 m²

Proçesi i prodhimit ka baze lenden e pare me baze organike te cilen ua blejne kompanive prodhuese,ku i pergjigjet rigorozisht kategorizimit te Ligjit Nr. 60/2014 "Për një ndryshim në ligjin nr. 10448,datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit",të ndryshuar".

Karakteristikat e tokes dhe karakteristikat e objektit

Objekti ku zhvillohet veprimtaria eshte ne Fshatin Velmish,Njesia Administrative Strume, Bashkia Roskovec, Rrethi Fier, Qarku Fier me nje siperfaqe totale prej 10866 m². Subjekti Vellezerit Hoxha 2007 eshte nje stabiliment ku behet përpunimi, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ.

Koordinatat Gauss Kryger te vendodhjes se aktivitetit (Albanian 1986 / GaussKruger Zone 4) jane si meposhte:

E: 4395683.85

N: 4515054.75

Ne brendesi te kesaj zone vihet re nje sistem rrugor i mirefillte dhe nje pjese e kesaj hapesire eshte siperfaqe toka bujqesore te kultivura.

Ne kete zone kemi shume aktivite te ndryshme per aresye pozicioni si dhe lehtesise se komunikacionit. E tere hapesira ku zhvillohet aktiviteti eshte sistemuar, asfaltuar duke bere te mundur realizimin e nje imazhi pamor mjedisor me cilesor, dhe ka ndikuar ne permirsimin e ndotjes mjedisore dhe permirsimin e pamjes vizuale.

Kjo zone nuk eshte habitat per specie te rendesishme te flore dhe faunes.

Gjithashtu pozicionimi i aktiviteti ekzistues ne Fshatin Velmish, lehtesira ne aksesimin e tij si per furnizimin me lende te pare (bloqe mermeri te ngjyrave te ndryshme) dhe tregetimin e tyre me pakice por edhe per

automjetet e zjarrfikses ne rast te aksidenteve te mundeshme si renia e zjarrit apo ambulancave ne rastet e aksidenteve me pasoje ne shendetin e punonjesve.

Zona e perzgjedhur per ushtrimin e ketij aktiviteti eshte e pershtatshme per kete lloj aktiviteti duke pasur parasysh perparisist si furnizimi me energji elektrike.

Te dhenat teknike te aktivitetit

Procesi i perpunimit te gurit, prerjes dhe lustrimit te tij fillon sipas nje procesi standart punes, sipas hallkave te meposhtme ne varesi te llojit te gurit qe do te perdoret. Pajisjet qe do te perdoren per zhvillimin e ketij aktiviteti jane:

- Makina e prerjes se gurit
- Transportjer spiral
- Pajisje zmeriluese

Te gjitha keto pajisje jane te vendosura ne nje tavoline me kembe metalike. Guri qe do te perdoret me ane te nje piruni vendoset ne transportierin (mekanizem i inkorporuar ne tavoline) dhe fillimisht kalon ne makinen e prerjes se gurit. Makineria eshte e pajisur me thika ne formen e sharres te madhesive te ndryshme ne baze te madhesise se gurit qe do te pritret. Levizja e sharres kryhet ne kater drejtime para-pas dhe larte-posht me nje gjatesi rreth 50 cm per te realizuar prerjen e deshiruar. Ne sharren prerese eshte i inkorporuar ne sistem ne forme depozite e cila ben te mundur larjen e gurit dhe njekohesht sprucimin per minimizimin e pluhrave qe krijohen nga prerja e gurit. Pasi prerjes se gurit ne tabake te madhesive te ndryshme ne varesi te kerkeses dhe projektit qe do te zhvillohet, tabaku me ane te transportierit spiral kalon ne pajisjen zmerilizuese ku i jepet forma dhe pastrohet per here te dyte nga ndonje papasterti e mbetur. Ne kete makineri merret forma dhe kryhet zmerilizimi i tabakut prej guri dhe pas kesaj ne nje tavoline mund te kryhen edhe zmerilizime apo prerje te tjera me te imta me ane te trakove te dores te cilat perdoren nga punonjes te specializuar. Ujrat te cilat do te vijne nga larja e gurit ne makinen prerese dhe nga sprucimi me ane te kuneve te cilat jane ne te gjitha perimetrin rrethues te kapanonit metalik do te kalojne ne nje grope dekantuese. Pasi pluhuri bashkohet me uje krijohet nje lende ne forme llumi fluid i cili ka ne perberje me shume uje sesa pluhur. Pas kalimit ne kuneta te cilat jane te ndertuara me pjerresi sipas standartit materiali i depozituar ne gropen dekantuese uji i cili do te qendroje ne siperfaqe pas precipitimit te lendes se ngurte do te merret me ane te nje pompe te levizshme dhe do te perdoret per mbushjen e depozites ne makinerine prerese. Meqenese ky uje eshte i paster atehere mund te perdoret lehtesisht duke na krijuar nje sistem te mbyllur dhe pa humbje te medha te ujit. Ne proces do te rifusim rreth 80 % te ujit qe ndodhet ne gropen dekantuese dhe do te duhet te shtojme rreth 20 % te tij. Llumi i precipituar do te terhiqet nga kompanite e ndertimit per tu perdorur ne proceset e tyre. Ai do te shitet me ane te faturave tatimore nga subjekti. Pjeset e prera te gurit do te perdoren per vepra te tjera ne varesi te projektit. Meqenese aktivitetit merret kryesisht me ndertimin e varreve ato do te futen ne ndertimin e bazamentit te betonit perpara se te vendoset struktura e mermerte. Zakonisht sasia tyre eshte e vogel pasi punohet qe guri te shfrytezohet ne maksimum pasi gjithcka perkthehet ne kosto per operatorin. Ne rast se kjo sasi do te rritet operatori nuk do ta lej ne vendndodhje por do te lidhe kontrate me me kompani te licensuara sipas dispozitave ligjore per materialet inerte.

2. Lenda e pare dhe ato ndihmese, sustancat e tjera dhe energjie perdororur ose e gjenerar nga instalimi;

Lendet e pare dhe ato ndihmese qe do te perdoren ne kete proces pune jane lende si blloqe mermeri te cilat do te sigurohen nga tregu vendas/importi, uje dhe energji elektrike sigurohen nga tregu vendas.

3. Burimet e shkarkimeve nga instalimet;

Tabele 1: Shkarkimet ne ajer

Pyetje	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A ka shkarkime ne ajer?		Jo	Aktiviteti nuk shoqerohet me emetime pluhurash. Aromat e mundeshme e nenshtrohen masave nepermjet aspirimit shoqeruar me filtrimin e ajrit ne mjediset e mbyllura
A ka shkarkime ne ajer (nga burime te shperndara)?		Jo	Pasi perdoret me energji elektrike te cilet nuk shkaktone ndotje ne mjedis
A ka erera te keqija nga shkarkimet?		Jo	Ne vleresim qe u be ne terren, nuk u konstatuan aroma te pakendshme jashte normave te lejuara.

4. Kushtet ne vendndodhjen e instalimeve dhe rastet e njohura historike te ndotjes;

Vendodhja e prones ndodhet ne nje zone te miratuar si zone per zhvillim te industrise. Ne keto mjedise nuk ka raste te njohura historike ndotje apo pika e nxeha ekzistuese.

5. Nayra dhe sasite e shkarkimeve te pritshme nga instalimi ne cdo vend/mjedis si dhe identifikimi i efekteve me te rendesishme te shkarkimeve ne mjedis;

Tabele 2: Shkarkime te ujerave te ndotura

Pyetje	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A ka shkarkime te ujrave te ndotura?	Po		Ujrat e ndotura te zeza nga sistemi i vete objektit per nevoja sanitare.
A ka ujera te ndotura me natyre toksike?		Jo	Ky aktivitet nuk eshte aktivitet qe perdor element te rrezikshme per mjedisin dhe shendetin e

			punonjesve.
A behen shkarkime ne rrjetin e kanalizimeve?	Po		Zona eshte nje zone ekzistuese ku kane ekzistuar sistemet e kanalizimeve.
A behen shkarkime ne siperfaqen ujore?		Jo	Aktiviteti nuk ka të bëjë me ndikime në sistemin e drenazhimit të zonës pasi nuk ben shkarkime.
Jepni sasine e ujerave te ndotura (m ³ /dite)	0.3 m ³ /dite		

Tabele 3: Mbetjet e ngurta

Pyetje	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A gjenerohen mbetje te ngurta?	Po		Në këtë linje gjenerohen mbetje urbane në formë sterile e të pa demshme për mjedisin. Mbetjet e ngurta menaxhohen sipas legjislacionit ne fuqi, me kompani te licensuara.
A gjenerohen mbetje te ngurta te rrezikshme?		Jo	Ky aktivitet nuk eshte aktivitet qe perdor element te rrezikshme per mjedisin dhe shendetin e punonjesve si toksik apo korrozive.
Te asgjesuara ne territorin e impjantit/instalimit?		Jo	Mbetjet nga aktiviteti jetesore grumbullohen ne kontenier te vecante dhe me pas largohen ne vendin e caktuar nga pushteti vendor.

Tabele 4:Perdorimi / sigurimi i energjise

Perdorimi / sigurimi i energjise	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A perdorni energji?	Po		Kapaciteti i konsumit te energjise elektrike varion sipas muajve dhe kapaciteve ditore perpunues, nje mesatare mund te arrij deri 1130 Kw /muaj

A perdoret kjo energji ne territorin e impiantit apo sigurohet nga burime te tjera?		Jo	Kjo sasi e energjise elektrike perfitohet nga OSHEE konform nje kontrate te lidhur midis dy paleve
Konsumi i lendeve djegese per sigurimin e energjise nese prodhohet ne impiant/instalim?		Jo	Nuk prodhohet ne kete instalim.
Informacion tjeter sqarues?			-

Tabele 5: Zhurma & vibracione

Pyetjet	PO	JO	Nese PO pershkruaj (tipin, sasine & burimin)
A gjenerohen zhurma?	Po		Nga procesi i zakonshem i pune por ne nivele te moderuara.
A gjenerohen vibracione?		Jo	Procesi nuk ka te bej me vibrime por me nje proces te thjeshte dhe mekanik dhe termik
A gjenerohen zhurma ne sfond		Jo	Ne kete veprimtari nuk ka prezence te bokse per muzik apo per te shkaktuar shqetesim te zones perreth.

6. Teknologjia dhe teknika te tjera te propozuara per parandalimin e shkarkimeve ose kur kjo nuk eshte e mundur, per pakesimin e shkarkimeve nga instalimi, vecanerisht duke zbatuar TMD;

Menaxhimi i mbetjeve ngurta

Administrata dhe punonjesit i kushtojne vemendje te vecante edhe ketij aspekti per te parandaluar ndotjen ne mjedis nga perhapja e mbetjeve te gjeneruara. Shoqeria ka nje plan te menaxhimit te mbetjeve. Ne kete plan duhet te percaktohen qartesisht menaxhimi qe do ti kryhet seciles nga tipet e mbetjeve. Synimi i kompanise eshte ne riciklim total te mbetjeve te gjeneruara.

Menaxhimi i mbetjeve te lengta

Sic u theksua dhe me siper nuk kemi gjenerim mbetjesh te tilla, sistemi eshte i lidhur me rrjetin urban te kanalizimeve.

Menaxhimi i shkarkimeve ne ajer

Nuk ka emetime te demshme dhe ambjenti ka nje ventilim per te larguar keto aroma. Te kontrollohet ne menyre rigoroze cilesia e naftes qe perdoret per mjetet e transportit. Ne raste avarie te ndalet perdorimi dhe te kryhet riparimi i nevojshem. Per sa i perket shkarkimeve nga mjetet e transportit te perdoret nafta cilesore, te kryhet kontrolli periodik gjendjes teknike dhe te riparimet e nevojshme nese nevojitet. Nje kujdes te vecante duhet kushtuar ne rast te nderrimit te gazit te frigorifereve pasi ato permbajne CFC te cilat ndikojne ne shtresen e ozonit. Nderrimi i gazit te kryhet ne perputhje me standartet nderkombetare te industrise.

Ndotja akustike

Ndotja akustike do te gjenerohet gjate procesit te punes se hyrjes dhe daljes se makinave ne furnizimin me lenden e pare, e cila zhvillohet ne zona urbane dhe kjo zhurme eshte brenda normave te lejuara sipas normative se zones.

Programi i monitorimit dhe elementet e tij

Ne perгатitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga laboratore te nenkontraktuar nga vete shoqeria ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, rregjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (AKM). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vete kompania dhe do te dorezohen ne DRM e Qarkut Fier sa here ju kerkohet, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve.

7. Alternativat ne zgjedhjen e vendit te instalimit dhe teknologjise se perdorur;

Perzgjedhja e vend-ndodhjes se objektit eshte bere duke nxjerre te gjitha kondicionet teknike urbane dhe funksionale te llojit te sherbimit te vete aktivitetit ekzistues ne pronen prane projektit te propozuar.

Alternativa " 0 "per mos zhvillim te kesaj veprimtarie do te sillte impakt ne rritjen e papunesimit ne kete zone te , Bashkia Roskovec. Ky impakt do te ishte ne nje nivel te ndjeshem per Bashkine Roskovec pasi ne kete aktivitet jane punesuar disa punonjes.

Ky objekt eshte perzgjedhur si alternativa me e mire e mundshme duke qene se eshte nje objekt ekzistues i miratuar si objekt per zhvillim tregtar. Ky objekt ndodhet larg zonave te mbrojtura apo me status te vecant.

8. Masat per parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve;

Ndikimet tek njerezit, ndertesat dhe objekteve per komunitetin nga njeriu.

Zhvillimi i aktivitetit linje prodhimi produkte kozmetike ne drejtim te mjedisit human. Ky ndikim eshte shume planesh. Ai mund te jete I drejtperdrejte ose I terthore, sikurse mund te jete negative, ashtu edhe pozitiv. Duke u mbeshtetur ne faktin se aktiviteti zhvillohet ne territorin e Bashkise Roskovec analiza e ketyre aspekteve merr vlera te vecanta.

Ndryshimet ne popullsi. Vendndodhja e objektit ku zhvillohet ky aktivitet ndodhet ne Fshatin Velmish, Njesia Administrative Strume, te Bashkise Roskovec, Rrethi Fier. Duke qene se dhe zona eshte nje zone ku jane kryer aktivitetet industriale ndikimi ne mjedis ka nje influence mjaft te vogel gati e pa konsiderueshme ne krahasim me ndikim pozitiv qe i sjelle popullsise se zones venia ne pune dhe punesimin e nje numeri te madh punonjesish per kete aktivitet kemi rritje te punesimit te fuqise punetore te zones.

Ndikimet e dukshme te projektit te zhvillimit ne zonat rrethuese dhe pejsazh.

Implementimi i projektit perkon me karakteristikat e zones keshtu qe zona sot eshte nje zone ku jane ndertuar objekte industriale te cilat ne harmoni me objektin bejne zhvillimin ekonomik te zones. Implementimi i projektit favorizon dhe keto aktivitetet mbasi te gjitha industrite e zones do te furnizohen me produktin qe do te tregtohet nga ky subjekt. Nivelet dhe ndikimet e emetimeve te ardhura nga projekti i zhvillimit gjate fazes normale te operimit. Zhvillimi i projektit ka parashikuar masa te rrepta konform legjislatures ne fuqi per ruajtjen dhe administrimin e ambalazheve.

Ndikimet potenciale nga magazinimi dhe dorezimi i ambalazhit produkt i gatshem do te lehtesohen nepermjet perdorimit te praktikave me te mira menaxhuese, te cilat jane praktikate qe njesi publike dhe private adoptojne per parandalimin e ndotjes ne operimet e tyre.

Monitorimi dhe kushtet e transportit sipas te cilave subjekti do te transportoje produktin e gatshem mund te beje dergesa duhet te jene pjese e procedurave te subjektit dhe te implementohen nepermjet kontrates derguese.

Nivelet dhe ndikimet e zhurmave nga projekti zhvillues. Zhurmat e emetuara nga operimi do të jenë sipas standarteve ndërkombëtare të 70dB për zonat tregtare/industriale.

Ne bazën e furnizimit nuk do të ketë levizje të vazhdueshme të automjeteve të cilët do të kryejnë aktivitetin në subjektin në fjalë dhe në subjektet përreth. Si në rastin e furnizimit, atë të depozitimit dhe në rastin e shpërndarjes faktori i ndikimit të zhurmave do të jetë i pandieshëm dhe në asnjë rast nuk do të kalojë 85dB(A) në një min.

Konsekuenca të tjera ekologjike: Konsekuenca të tjera ekologjike mund të përmendim dhe në **Mjedis social – ekonomik dhe ndikimet në mjedisin human.**

Në sektorin privat peshën më të rëndësishme e kanë industria e ndërtimit që ka edhe peshën kryesore në punësim, tregtia, industria e lehtë dhe ushqimore (pije, qumësht, buke, sallam, prodhim vaji, vere, raki), mobilerite, (prodhim dhe riparim), konfeksionet për import dhe rrobaqepsite, kepuce etj. Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ndikojnë direkt në drejtim të mjedisit human. Ai mund të jetë i drejtperdrejtë ose i terthorë. Duke u mbështetur në faktin se këto produkte i shërbejnë popullatës së zonës në fjalë të Fshatit Velmish, Bashkia Roskovec kështu që impakti pozitiv rritet jo vetëm për banorët e zonës përreth edhe për rajonin e Roskovec në teresi.

Ndikimet në ujë:

Ndikimet e projektit në modelin drenazhues veprimtaria të bëhet mbi bazën e një projekti ku kullimi i ujrave sipërfaqësore si dhe disiplinimin e tyre në gjithë territorin e objektit. Duhet të theksojmë se territori për implementimin të aktivitetit ka qenë zonë e banuar me rrjet të rregullt kanalizimesh dhe është funksional. Sistemit dhe drenazhimi do të jetë mjaft efikas mbasi rrjedhjet ujore drejtohen në sistemin e kanalizimeve ekzistuese.

Ndryshimet e karakteristikave të tjera hidrografike si psh. niveli i ujrave tokësore, i rrugëve ujore, i rrjedhës së ujrave nëntokësore. Gjate zhvillimit të veprimtarisë nuk evidentohet të karakteristikave hidrografike. Sistemi i kanalizimeve shfrytëzohet duke u bazuar mbi rrjetin e kanalizimeve ekzistuese.

Ndikimet në hidrologjinë bregdetare dhe të shtretërve. Nuk jemi në zonë bregdetare dhe nuk kemi influencë të tilla.

Ndikimet e ndotësve, mbetjeve etj. Në cilësinë e ujit. Në projekt janë planifikuar duke u marrë të gjitha masat kundër ndotjes nga shkarkimet e ujrave pa kontroll, mbetjeve të ndryshme. Të gjitha këto mbetje janë parashikuar nga subjekti ku dhe si do të ruhet që ndikimi të jetë sa më i qetë.

Ndikimet në ajër dhe në klimë

Niveli dhe përqendrimi i emetimeve kimike dhe ndikimet e tyre mjedisore. Produktet që prodhon subjekti dhe pse janë të ambalazhuara mirë duke respektuar kushtet e standartit dhe ambalazhimit ambientit duhet të plotësojë kushtet nominale të ambientit duhet që ambienti të jetë i ajrosur pa lageshti të mos ketë ndotje, të ketë ventilim.

Lendet e veçanta. Ne proces lendet e veçanta nuk mund te pershkruajne si lende te veçanta mbasi te gjitha nenproduktet kimike jane te karakterit kimik por gjithmon uljen e ketyre ndikimeve parashikohen ne projekt ku eshte e domosdoshme zbatimi me rigorozitet i rregullores per tregetimin e ketyre lendeve.

Aromat sulmuese. Gjate zhvillimit te aktivitetit mund te kete perhapje ere e cila mund te ndikojne ne ndotjet si rezultat i daljes ne ajer i ndotesve aromatik te nenprodukteve te lehta. Kjo influence eshte gjithmon e kontrollueshme dhe pasojat nuk jane me rrezik per njerezimin mbasi produktet kimike helmuese si H₂S sqfuri apo ndonje element tjetër i demshem nuk ekziston ose kur kemi largohen qe ne fabriken keshtu qe perbersat kimik ndotin deri diku ambientin vetem ne rast te rralla po pa rrezik per punonjesit.

Ndikime te tjera klimatike. Ne kete rast duhet te merret ne konsiderate ndikimet qe vijon si rezultat i ngritjes se temperaturave te larta ne kohen e veres per kete me rigorozitet duhet te zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes nga zjarri

Ndikimet nga trafiku (rruga, hekurudha, ajri, uji) qe lidhen me projektin. Keto ndikime jane te pa ndieshme mabsi pozicioni i vendosjes se objektit ku zhvillohet aktiviteti eshte ne nje zone jashte qendrave te banuara dhe ku trafiku rrugor i perket nje zone te lokalizuar keshtu qe ne kete rast ndikimet per transport jane shume te vogla gati te pa konsiderueshme.

Ndikimet e lindura nga grumbullimi dhe konsumimi i materialeve, uji, energjise ose burimeve te tjera, si pasoje e zhvillimit te aktivitetit.

Si rezultat i grumbullimit te lendes ne depozita jane marre nje ser masash drastike te mbrojtjes kundra zjarrit, rregullave te sigurimit teknik gjate shfrytezimit qe te gjitha jane parashikuar ne procesin teknologjik te funksionimit te ketyre. Kjo ka bere qe ndikimet jane shume te vogla dhe per çdo ndryshim te parametrave konstatohet nga monitorimi i vazhdueshem qe i behet procesit.

Ndikimet e projekteve te tjera qe shoqerojne projektin e dhene si psh , rruget e reja, kanalet e ujerave te zeza, banesat linjat e energjise, naftë dhe gaz – sjellesve, telekomunikacionet etj. Rruget e reja kanalizimet linjat elektrike behen qe ne fazen e ndertimit dhe mbasi zbatohen normativat teknike te administrimit te ketyre proceseve ndikimet nuk japin sens negative. Gjate zhvillimit te aktivitetit punonjne njerez te cilet ndjekin hap pas hapi te gjitha dukurite qe rrjedhin nga procesit te shperndarjes apo çdo rasti tjetër.

Ndikimet shoqeruese te projektit me projekte te tjera ekzistuese ose te propozuara. Projekti implementohet qe ne fazen fillestare dhe nuk nderfutet me projekte te tjera ekzistuese apo te propozuara. Ne çdo rast qe do te lind nevoje parashikohen qe ne projekt uljen e ketyre ndikimeve.

Ndikimet sekondare qe rezultojne nga nderveprimi i ndikimeve te tjera direkte, te listuara me sipër. Çdo ndikim tjetër sekondar eshte i monitorueshem dhe per çdo kostatim personeli merr masat apo kerkon projekte te veçanta ku parashikohet dhe parandalimi i ndikimeve sekondare.

Masat zbutese

Te identifikohen masat per te eleminuar apo zbutur ndikimet negative ne mjedis duke dhene disa alternativa per veprimtarine qe do te ushtrohet. Atje ku jane identifikuar ndikime negative te dukshme, te pershkruhen masat qe do te merren per te menjanuar, zvogeluar ose ndrequr keto **ndikime**.

a. Planifikimi i zone. Nga analiza e mesiperme verejme se gjate veprimtarise ekzistojne disa faktore te cilet kane mundesi te ndikojne negativisht ne mjedisin e zones dhe me gjere. Ne qofte se gjate veprimtarise i kushtojme kujdesin e duhur ketyre faktoreve, per t'i patur vazhdimisht nen kontroll, ky ndikim eshte e mundur te minimizohet ne maksimum.

b. Masat teknike, psh procesi selektiv, trajtimi dhe kontrolli i ndotjes. Gjate zhvillimit te veprimtarise behet ndjekja me kujdes e Programit te Menaxhimit Mjedisor i cili merr ne konsiderate dhe analizon te gjitha llojet e ndikimeve dhe masat e nevojshme per eleminimin e tyre. Gjate veprimtarise i kushtojme kujdesin e duhur ketyre faktoreve, per t'i patur vazhdimisht nen kontroll, ky ndikim eshte e mundur te minimizohet ne maksimum.

c. Masat estetike dhe ekologjike, si psh, ngjyra, etj, pejsazhimi, mbjellja me peme, masat per ruajtjen e habitateve ose per te krijuar habitate alternative, regjistrimi i zonave arkeologjike, masat per te ruajtur zona ose ndertime historike.

Rahabilitimi i elementeve te peisazhit

Programi i pergjithshem i Menaxhimit Mjedisor dhe Plani per zbutjen e ndikimeve parashikon realizimin e sheshimeve dhe te mbushjes se gropave te mundeshme qe do te krijohen gjate ristrukturimit te territorit.

Me rehabilitimin e zones ne kete territor do te kuptojme me sistemim gjelberim te zones duke e shikuar zonen ne kompleks me gjithë aktivitetet e tjera qe operojne ketu. Per permiresimin e kushteve ambientale ne kete territor duhet qe bashkerisht te investohet per sistemimin gjelberimin dhe rregullimin e infrastruktures se zones.

Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese

Analiza e perdorur per te permbushur kerkesat mjedisore eshte sipas standarteve nderkombetare. Vleresimi i gjendjes mjedisore vendos kushtin fillestar mbi vendin dhe vlereson ndikimin e facilitetit gjenerues te propozuar mbi burimet e zones. Ndikimet e mundeshme pozitive dhe negative te ketij aktiviteti.

Jane percaktuar masat lehtesuese qe duhen marre gjate zhvillimit te aktivitetit dhe funksionimit te facilitetit si dhe gjithashtu eshte identifikuar edhe ndonje ndikim i mbetur negativ.

Modelimi u krye si nje pjese e VQM per te vleresuar ndikimet e emetimit te ajrit ne cilesine e ajrit lokal. Rezultatet e modelimit tregojne qe pika e tregimit do te jene sipas te gjitha standarteve nderkombetare te perqendrimit te cilesise se ajrit.

9. Masa per perdorim me eficence te energjise;

Nje nga masat e propozuara do te jete pergatitja e nje raporti auditimi energjistik nese konsumi i energjise do te jete e nje prodhuesi te madh. Një studimi i mikro-klimës mund ta plotesonte studimin e vleresimit e gjendjes mjedisore nëpërmjet ofrimit të dhënave shtesë lidhur me ndikimin e përqëndrimeve dhe zhvillimit. Rekomandohet te rishikohet si mundesi studimi ne fazen kur AKM do e vleresoj si te domosdoshme.

Në të njëjtën mënyrë edhe prodhimi i energjisë së gjelbër (shfrytezimi i mundesive te energjive te rinovueshme) është një fushë që mund të inkurajohet nga ligjet e planifikimit dhe të taksave. Propozimi i propozuar per kete zone ku ditet me dielle jane ne mesatare te pranueshme, vleresohet perdorimi i energjive te rinovueshme si sistem diellore (panela diellor per uje sanitare duke qene se kane nje konsum te larte te ujit dhe nevojave per ngohjeve e mjedisit te punes si nje mundesi per uljen e konsumit energjistik nga energjia elektrike.

10. Masa te tjera te planifikuara ne perputhje me parimin e pergjithshme qe rregullojne detyrimin themelor te operatorit;

Plani i menaxhimit per zbatimin e projektit mbeshtetet mbi programin qe ben subjekti ne menyre periodike gjate zhvillimit te aktivitetit.

Pra per kete jane hartuar programe dhe egziston dokumentacioni perkates per kontrollin institucional pales shqiptare si dhe llogaritjen e mbetjeve teknologjike asgjesimi i tyre.

Subjekti ka proces verbale te sakta ku verteton nje pune korrekte e sistematike ne drejtim te marrjes se masave kunder ndotjeve ne mjedis.

Hartohet nje plan i detajuar i zhvillimit te veprimtarise te percaktuar me nje grafik qe ndryshe quhet grafiku i zhvillimit te aktivitetit.

Te pergatitet plani i monitorimit te ndikimit ne mjedis

Ne terma konkret subjekti do te raportojë çdo tre muaj prane Agjencise Kombetare te Mjedisit mbi rezultatet e monitorimit qe do te konsistojne ne

- Matjen e nivelit te zhurmave ne mjediset e punes
- Evidentimin e ndotjeve eventuale nga tregetimi i produkteve te mesiperme
- Masat per sistemimin e materialeve te ngurta mbetjet teknologjike, ambalazhet e per riciklim.

Monitorimi do te vazhdoje per gjate gjithë kohes se zhvillimit te aktivitetit, deri ne perfundim te ciklit mekanizmi, shperndarje, asgjesimi i mbetjeve etj.

Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar pasojat nga ndikimet mjedisit zhvilluar per çdo faze dhe do te merren masa per perballimin e ndotjeve te mundeshme. Kjo lejon nje matje te sakte qe implementohet per te shmangur demet qe do te shkaktoheshin me vone.

Rreziqet e aksidenteve

Veprimtaria qe ushtron subjekti nuk parashikon rrezik aksidental te pa parashikuar nga direktivat, ose te Rregullimeve implementuese. Megjithate ne raste se ne vazhdimesi te aktivitetit do te kete raste te ndryshimit te lendeve te para te cilat japin efekte negative ndaj ambienti apo ne lidhje me njerezit. Ne kuadrin e monitorimit te procesit Agjencia Kombetare e Mjedisit ne kontrollet periodike qe ajo planifikon gjithmone do te jete e vemendeshme qe çdo medikament i ri qe mund te futet apo te zevendesohet do te beje kontrollet e mundeshme dhe po te dal nevoja dhe matjet eventuale te mundeshme qe mund te kerkohen.

- Mbetjet teknologjike te cilat prodhon mbetje te ngurta teknologjike me veti te demshme per njerezimin
- Mbetjet e natyres urbane, qe prodhohen nga njerezit qe punojne aty, jane minimale. Po ashtu produktet qe i shiten klientit nuk lene mbetje, mbasi ato shiten se bashku me amballazhin
- Instalimi elektrik jane te tipit hermetik, dhe nuk sjellin problema ne ndikime ndaj mjedisit.
- Te zbatohen kerkesat per ventilimin e ambienteve dhe ajrimin e plote te magazines.

Ka marreveshje me vete, ne fuqi qe lidhen me mbajtjen ose perdorimin e substancave te rrezikshme, dhe Ekzekutivi per Shendetin dhe Sigurine, i siguron autoriteteve lokale te planifikimit keshillime rreth vleresimit te rrezikut mbi aplikimin e planifikimit qe perfshin nje instalim te rrezikshme. Megjithate, eshte mire qe atje ku eshte e mundur, rreziku i aksidentit dhe i ndikimeve kryesore mjedisore, te konsiderohen se bashku, dhe qe projektuesit dhe autoritetet planifikuese, duhet te kene gjithmon parasysh kete gje